



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3138 Prot.

Roskovec, më 01.07 2020

VENDIM

NR 50 .DATË 29.06 .2020

“PËR PËRDITËSIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË NDODHEN NË TERRITORIN E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN ,BASHKIA ROSKOVEC”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma k) ; Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar) neni 6, pika 2, gërma b); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, neni 37 pika 1; Ligjit Nr.111/2018 “Për Kadastrën”, neni 2, gërma c, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr.1210 datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të **Komunës Kuman**, Qarku Fier” (i ndryshuar me VKM nr.399 datë 8.5.2013) dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr.20, datë 20.02.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në listën përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat janë në territorin e Njësisë Administrative Kuman, nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec, të Qarkut Fierit, me Vkm nr.1210, datë 11.12.2009”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Përditësimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kuman, Bashkia Roskovec të miratuar me VKM nr.1210 datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të **Komunës Kuman**, Qarku Fier” (i ndryshuar me VKM nr.399 datë 8.5.2013) dhe Vendim të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr.20, datë 20.02.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në listën përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat janë në territorin e Njësisë Administrative Kuman, nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec, të Qarkut Fierit, me Vkm nr.1210, datë 11.12.2009”
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

